



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M
Nr. 56, date 24.06.2019**

**PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR TË NDERIT
“MIRËNJOHJA E BASHKISË SHKODËR” PASTOR DRITAN PROJ**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 24.6.2019, me propozim të një grupi anëtarësh të komuniteteve të Kishave Ungjillore në Shqipëri, Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv Metropolitan, përfaqësues të organizatave të ndryshme jo-qeveritare në qytetin Shkodër, mbështetur në nenin 54 shkronja “m”, neni 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 15 të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 61, datë 30.11.2016 “Rregullore për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre“, relacionit datë 11.06.2018 të komisionit këshillimor për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Dhënien e titullit vendor të nderit “Mirënjohja e Bashkisë Shkodër” Pastor **Dritan Proj** (pas vdekjes), me motivacionin:

“Për kontribute të çmuara, në fushën e edukimit shpirtëror (Pastor në Kishën Ungjillore “Fjala e Krishtit) dhe social, kurdoherë i gjëndur pranë të varfërve dhe familjeve në nevojë; misionar i paqes dhe mirëkuptimit kundër fenomenit të gjakmarrjes, duke u bërë shëmbulli i një trashëgimie të vyer frymëzimi në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes”

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 24.6.2019
Shpallur në datën 24.6.2019

Sekretar i këshillit

K R Y E T A R

Suel Hadri

Xhemal BUSHATI